



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Ac.nr.10255/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtarin individual Liridon Maloku, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Inspektorati i Punës në Pejë, kundër debitorit N.T.SH. “Xh.” me seli në Pejë, të cilën e përfaqëson me autorizim avokati A.N, për shkak të pagimit të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë, EP.nr.492/2020, të datës 13.09.2021, me datën 28.03.2022, mori këtë:

### A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit N.T.SH. “Xh” me seli në Pejë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë, EP.nr.492/2020, të datës 13.09.2021, VËRTETOHET.

### A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, EP.nr.492/2020, të datës 13.09.2021, e ka refuzuar në tërësi prapësimin e debitorit N.T.SH. “Xh.” me seli në Pejë, i paraqitur kundër urdhrin përmbarimor P.nr.148/20, i datës 27.02.2020, i caktuar nga Përmbaruesi Privat Zija Bala për territorin e Gjykatës Themelore në Pejë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të anulon aktvendimin e Gjykatës Themelore në Pejë.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar kreditori.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 27.02.2020, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbarimit kundër debitorit N.T.SH. “Xh.” me seli në Pejë, ndërsa Përmbaruesi Privat Zija Bala, me datën 27.02.2020, nën shenjën, P.nr.148/20, e ka lejuar ekzekutimin në bazë të dokumentit përmbarimor-vendimit të Inspektoratit të Punës Nr.202/19 e datës 02/09/2019, i plotfuqishëm me datën 16.12.2019, dhe i ekzekutueshëm me datën 16.12.2019, me bazë juridike për pagimin e masës ndëshkimore në shumë prej 4,800.00 euro, të paraparë më gjerësisht si në propozimin për përmbarim.

Kundër urdhrin për përmbarrim P.nr.148/20, i datës 27.02.2020, debitori me datën 04.03.2020, ka ushtruar prapësim, ndërsa kreditorja nuk ka ushtruar përgjigje në prapësim.

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin EP.nr.492/2020, të datës 13.09.2021, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe e ka vërtetuar urdhrin përmbarrimor.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182 par.2 të LPK, për arsye se është i kuptueshëm, i qartë dhe përmban arsye bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të dispozitave të procedurës përmbarrimore dhe për shkak të vërtetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike, e cila nuk vihet në dyshim me asnjë pretendim ankimor, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar tërësisht si të pabazuar prapësimin e debitorit duke e lejuar urdhrin përmbarrimor P.nr.148/20, i datës 27.02.2020, sikurse në aktvendimin e ankimuar.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga palët ndërgjyqëse, ka vendosur drejtë kur e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar. Gjykata e shkallës së parë, me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, ka konstatuar drejtë faktin se vendimi i Inspektoratit të Punës, Nr.202/19 e datës 02/09/2019, i plotfuqishëm me datën 16.12.2019, dhe i ekzekutueshëm me datën 16.12.2019, me bazë juridike për pagimin e masës ndëshkimore në shumë prej 4,800.00 euro, në bazë të cilit organi përmbarrues ka caktuar përmbarrimin, është titull përmbarrimor dhe si i tillë i plotëson kushtet e parapara në nenin 21, nenin 22 para. 1.2, nenin 23 para.2, nenin 24 paragrafi 3 si dhe nenin 27 para.1 të LPP-së, dhe mbi këtë bazë ky dokument me të drejtë trajtohet si dokument i përshtatshëm për përmbarrim. Prandaj, për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga palët ndërgjyqëse, ka vendosur drejtë kur prapësimin e debitorit e ka refuzuar si të pabazuar, duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar, se në bazë të nenit 71 të LPP-së, janë përcaktuar në mënyrë taksative shkaqet për të cilat mund të ushtrohet prapësimi, e të cilat shkaqe po që ekzistojnë, e pengojnë përmbarrimin e lejuar nga gjykata. Me nenin 69 paragrafi 4 të LPP-së përcaktohet se: “Baza për prapsim duhet të mbështetet në provat e duhura. Provat për prapsim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”. Në këtë rast debitori me anë të prapësimin nuk ka prezantuar asnjë provë me të cilin do të argumentohet ndonjërin nga shkaqet e parapara me nenin 71 të LPP-së, prandaj kjo gjykatë e vlerëson si të drejtë përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në procedurën përmbarimore ”në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në pajtim me nenin 208 e 209 pika (b) të LPK, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil  
Ac.nr.10255/2021, me datë 28.03.2022

Gj y q t a r i  
Liridon Maloku